



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 92, datë 25.09.2025

“PËR TRAJTIMIN, E Z. FETI OSMANLLARI ME APARTAMENT NGA FONDI I BANESAVE ME KOSTO TË ULËT QË DO TË NDËRTOHET NË LAGJEN 10 RRUGA “THEODHOR KAVALIOTI” MBI PASURINË 1/860 ZK 8561, SIPAS MARRËVESHJES NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE”

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot ,pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ekzekutivi si dhe bazuar në nenin 9 pika 1.1., 1.2, 24 dhe 54 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, Ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM 384 dt. 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore” etj

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI

- 1.Të trajtojë z Feti Osmanllari me apartament, nga fondi i banesave me kosto të ulët, që do të ndërtohet në Lagjen 10, rruga “Theodhor Kavalioti”, mbi pasurinë 1/860 zk 8561, sipas marrëveshjes nënshkruar midis Bashkisë korçë dhe Entit Kombëtar të Banesave”, referuar normave të strehimit në fuqi,
2. Trajtimi sipas pikës 1 do të bëhet vetëm nëse ai plotëson kriteret e legjislacionit në fuqi, në momentin e trajtimit me strehim.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI



Miratuar me 28 vota
Vota Pro 28
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 25-09-2025

